



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture,
Fforestry and Rural Development

DIVIZIONI PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN/DIVIZIE ZA JAVNO
OMUNICIRANJE/DIVISION OF PUBLIC COMMUNICATION

THIRRJE PËR APLIKIM

Për mbështetje financiare për shoqatat e prodhuesve dhe përpunuesve të produkteve bujqësore dhe agro-ushqimore

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për gjashtë mujorin e parë të vitit 2014 do të mbështesë organizatat dhe shoqatat e prodhuesve, përpunuesve të produkteve bujqësore dhe agro-ushqimore vendore, vetëm në një projekt brenda vitit kalendarik.

Të interesuarit duhet të aplikojnë për ofrimin e shërbimeve në këto fusha:

- Trajnime;
- Këshilla;
- Kampanje informative, tryeza, seminare, punëtori;
- Promovime, ekspozita, panaire;
- Aktivitete të karakterit garues;
- Ditë fushore.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Aplikacioni i plotësuar;
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi nga banka për xhironlogarinë bankare të aplikuesit;
- Projekt propozimin/ planin e biznesit;
- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
- Certifikata e regjistrimit të biznesit për personat juridik;
- Certifikatën e TVSH-së;
- Certifikata e Numrit Fiskal, dhe
- CV-t e ekspertëve.

Periudha e aplikimit:

Aplikimi zgjatë 10 ditë kalendarike dhe fillon prej momentit të shpalljes së thirrjes për aplikim.

Mënyra e aplikimit:

- Të gjithë aplikuesit fillimisht gjatë aplikimit janë të obliguar të plotësojnë formularin për aplikim, i cili është parakusht për përfitim të mbështetjes.
- Gjatë procedurës së shqyrtimit të dokumentacionit dhe kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve do të zbatohen masat ndëshkimore, duke u sanksionuar sipas nenit 38 Ligjit nr. 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.56/27.07.2009) dhe nenit 38 A Ligji Nr.04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.26/16 Tetor 2012).

Vendi i dorëzimit:

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Rr. "Nëna Terezë" Nr. 35 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Vërejtje:

- Dokumentet për aplikim duhet të dorëzohen në dy (2) kopje dhe brenda periudhës kohore të aplikimit.
- Dokumentet e dorëzuara pas përfundimit të afatit për aplikim, nuk do të pranohen për shqyrtim.